



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 19

Datë: 28. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 18/2024
3. Aktivitetet e SKQZ
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)
6. Raport i Këshillave të KQZ

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për furnizim me materiale të posaçme që u përkasin votuesve të verbër (shabllonët), për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
2. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe Listave të Votuesve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
3. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për furnizim me pajisje për sallën e takimeve të KQZ-së
4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shërbimet e instalimit dhe përkrahjes teknike të kamerave në vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
5. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për material administrativ për paket e vendvotimeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
6. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për transport për materialin sensitiv dhe josensitiv për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
7. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për vula të fletëvotimeve, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
8. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e doracakëve të trajnimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në Komunitet Lepsavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
9. Shqyrtimi dhe miratimi i programit orientues për anëtarët e KKZ në Komunitet Lepsavic, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
10. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit për anëtar të KKZ-së në Zveçan, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepsaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

11. Njoftim lidhur me fazat e informimit publik për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë e veriut

7. Këshilli për Personel

-Njoftim lidhur me procesin e rekrutimit të personelit të përkohshëm, për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë e veriut

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i udhëtimit zyrtar në Tiranë për takim pune**
2. **Të ndryshme !**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari z. Radoniqi e paraqiti agjendën e takimit. Pas kësaj, ai shtroi pyetje nëse dikush nga anëtarët ka ndonjë sygjërim, pyetje, propozim etj. Anëtarët, u pajtuan dhe me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Në vazhdim, u kalua në pikën e dytë. Sami Kurteshi, tha se ka vërejtje rreth vonesës së procesverbalit dhe se, nuk duhet të vonohet procesverbali! Gordana Llaban, bëri vërejtje rreth citimit të anëtarëve, të diskutimeve të tyre, siç konstatoi se 'dikujt i pasqyrohet fjala, e dikujt jo'! Më duhet të reagoj, tha ajo sepse 'fjala ime' nuk është pasqyruar si duhet, dhe në masën e duhur. Unë, këtë procesverbal nuk do ta votoj. Dhe, asnjë tjetër nëse 'dallimet' bëhen...

Sami Hamiti, tha se ky është procesverbal dhe 'nuk është transkript' dhe nuk mund të shkruhet secila fjalë që thuhet. Bile, jam ithtarë të jetë transkript!

Me 9 vota për, 1 abstenim (Sami Kurteshi) dhe 1 kundër (Gordana Llaban), u miratua procesverbali nr. 18/2024.

2. Aktivitetet e SKQZ

Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në lidhur me përgatitjet që po bëhen për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Tani, zyrat janë funksionale, mbahen takimet dhe zyrat janë pajisur edhe me vetura të huazuara nga MPB.

QV-të janë funksionale. Në Mitrovicën e veriut, do të jenë 7 qendra të votimit, dhe se edhe në komunat tjera janë funksionale: në Laposaviq, (janë 18 qendra, në kompletim e sipër), Zubin Potok, Zveçan (7 qendra).

Lista e votuesve, gjithashtu është duke u përgatitur drejt finales. Kemi marrë me 25 mars, ekstraktin e dytë nga të dy departamentet e ARC. Është duke u bërë krahasimi i të dhënave, ndryshimet etj.

Votimi jashtë vendit fillon më 29 mars, dhe përfundon me 3 prill, tha Ahmetaj. Janë dizajnuar formularët, si dhe përditësimi i të dhënave në platformën elektronike për të gjitha kategoritë e personave.

Ndërrimi i QV, është në proces. Periudha e ndërrimit të QV, ka filluar më 18 mars, dhe përfundon me 3 prill. Deri më 27 mars, janë pranuar 10 kërkesa për ndërrim të QV-së.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta:

Në vazhdim, me 11 vota për, u miratua kjo rregullore.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

Sami Kurteshi, para se të votohet kjo rregullore tërhoqi vërejtjen që rregullorja të shihet edhe menjëherë gjuhësisht, sepse janë do lëshime...

Pas kësaj vërejtje, me 11 vota për, u miratua edhe kjo rregullore.

5. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Arianit Elshani, elaboroi shkurtimisht këtë 'pako' të këtyre pikave të KOZ-it. Janë trajtuar gjërësisht në KOZ, i keni si 'dokumente', tha z. Elshani që, pastaj rekomandoi të votohen dhe, të vazhdohet me procedura e tjera.

Sami Kurteshi, bëri vërejtje te përmbajtjet e 'Droracakëvet' dhe tha se, një dokument i këtillë në fakt, duhet të shihet sepse, nuk është i shkruar mirë, dhe ai tha se "jam i befashuar" me mënyren e të shkruarit, me dokumentin...

Gordana Llaban, u interesua rreth materialeve për votuesit e verbër....! Sami Hamiti, tha se, janë materiale në kontinuitet si për të gjitha zgjedhjet, janë materiale specifike që votohen...

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për, miratuan rekomandimet e KOZ-it.

1. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për furnizim me materiale të posaçme që u përkasin votuesve të verbër (shabllonët), për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*
2. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe Listave të Votuesve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*
3. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për furnizim me pajisje për sallën e takimeve të KQZ-së*
4. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shërbimet e instalimit dhe përkrahjes teknike të kamerave në vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*
5. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për material administrativ për paket e vendvotimeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*
6. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për transport për materialin sensitiv dhe josensitiv për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*
7. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për vula te fletëvotimeve, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut*

8. *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e doracakëve të trajnimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë e veriut*
9. *Shqyrtimi dhe miratimi i programit orientues për anëtarët e KKZ në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë e veriut*

Ilir Gashi, foli rreth 'kamerave': ai pyeti se, a është vendosja e kamerave në përputhje me ligjin, pa e veçuar këtë momentum. Pra, ai tha se 'ka dilema'. Për QV, është ok por për QV, tha se ka dilemat e tij, sepse mund të ketë edhe ankime etj.

Arianit Elshani, shpjegoi se pse, qysh dhe si do të përdoren kamerat! Në fakt, ai tha se 'ky është një testim'...

Alban Krasniqi, tha se vendosja e kamerave është pjesë e dy rregullore të aprovuara, por edhe ligji i ri, thotë të rritet transparenca dhe kamerat, janë në këtë aspekt...

Burim Ahmetaj, kërkoi që të votohen edhe "Format zgjedhore" të cilat, janë shqyrtuar në KOZ por, vetëm formalisht, nuk është arritur të futen në agjendë të takimit...

Kjo, u la që të votohet në një takim "në distancë" nga KQZ.

Arianit Elshani, e informoi KQZ –në edhe për plotësimin me anëtar të KKZ-së në Zveçan, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leosavici, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Ai tha se, bëhet fjalë për znj. Diellza Peci nga AAK, e cila emërohet në komunën e Zveçanit si anëtare e KKZ.

Me 9 vota për, dhe 2 abstenime, u miratua ky rekomandim.

Arianit Elshani, foli edhe rreth votimit jashtë vendit, informimit dhe mbi stragjinë e informimit të votuesve. Informimi, do të bëhet edhe në mediat në gjuhën serbe në veri. Ende nuk ka kontraktor, sepse ende nuk është zhvilluar procedura kontraktuese...

6. Këshilli për Personel

Njoftim lidhur me procesin e rekrutimit të personelit të përkohshëm, për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në Komunitet Leosavic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovicë e veriut:

Alban Krasniqi, tha se plani është i avprovuar, janë 25 pozita. Sot, tha z. Krasniqi përmbillet edhe plani shtesë. Ka pasur 64 aplikime...

7. Shqyrtimi dhe miratimi i udhëtimit zyrtar në Tiranë për takim pune:

Burim Ahmetaj, tha se në këtë proces, do të përdoren ‘kamerat’ dhe ‘lapsat matrikulues’. Për ta funksionalizuar këtë proces, nga KQZ e Shqipërisë kemi kërkuar lapsat, dhe kamerat. Na duhet një takim pune mes dy KQZ-ve, si për marrëveshjen por edhe shkëmbimin e përvojave. Do jenë dy ekipe profesionale të KQZ lidhur me materializimin e takimit. E keni agjendën, tha Ahmetaj që, kërkoi miratimin e takimit...

Ekipi i parë: Arianit Elshani, Alban Krasniqi dhe Kreshnik Spahiu.

Ekipi i dytë: Fatos Lika dhe Naim Kaqiu.

Me 11 vota për, u miratua ky takim.

Kreshnik Radoniqi: E pranuar tani një shkresë lidhur me Soufverin. A ka nevojë për trajtim...?

Burim Ahmetaj: Na duhet vendimmarrja...

Me 11 vota për, anëtarët e KQZ-së, u pajtuan me ‘shkresën’ për souftver nga departamenti i IT që, i dërgohet OSBE-së.

8. Të ndryshme !